REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1091120
Datë/Datum. 22.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha eks. Shqyrtues Mentor Shala eks.Teknik	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***16.12.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***22.10.2020***	***Nr. i lëndës:*** ***1091/20***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.12.2020, OE **"VLERA" SH.P.K Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **1091/20,** kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "**DDD.SH.P.K.**" lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunës së Prishtinës "***, me nr. të prokurimit***:*** **616-20-3281-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK -PRISHTINË"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës kontrat publike korniz –Funizim vlera e parashikuar e kontratës **73 000,00 €**

Data e njoftimit për kontratë 30.06.2020,
Data e hapjes së ofertës 05.10.2020.
Data e njoftimit AK-së 26.11.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim 30.11.2020.
Data e vendimit mbi refuzim të kërkesës për rishqyrtim 03.12.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1: Qellimi
Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59: Egzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve. Neni 69: Aftesia teknike dhe profesionale.
Neni 60: Kriteret per dhenje te kontrates. Neni 66 : Përshtatshmëria Profesionale

Me datë 26.11.2020 kemi pranuar permes platformes E-prokurimi Njoftimin mbi vendimin e AK , ku komisioni i vleresimit na ka eleminuar per keto arsyeje:
1. "OE nuk sjellur deshmit qe paisjet tona kane sperkatje 5-50 mikron dhe 5-30 mikron"
2. "OE nuk ka sjellur deshmi per 5 pompa motorike LV".
3. "OE ka sjellur vetem nje ISO certifikate,mirpo nuk ka ofruar deshmit e kerkuara nga AK Certifikaten e analizave dhe MSDS te produktit qe do te perdoret".
Pas leximit te arsyjeve per eleminim konstatuam qe komisioni i vleresimit as qe i ka shfletuar dokumentet tona duke na diskriminuar me apo pa qellim.
Perpos mos perfilljes se Ligjit per Prokurim Publik ne kete Vendim dyshohet se ka shkelje te renda edhe te vepres penale nga AK respektivisht nga komisioni i vleresimit.
Me datë 02.11.2020 kemi pranuar B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit ku na eshte kerkuar sqarimi i shumices prej pikave te tenderit ,deshmit per 5 pompa LV , specifikacioni i paisjeve per mikronat si dhe MSDS.
Me date 05.11.2020 kemi dorezuar "Leter Sqarimin" per pikat e kerkuara edhe pse njeherit AK i ka pasur te gjitha keto ne dosjen qe e kemi dorezuar ne fillim.
Per piken e larte cekur si pika 1 : OE nuk ka sjellur deshmit qe paisjet tona kane sperkatje 5-50 mikron dhe 5-30 mikron"
Ne ne dosjen tone te tenderit tek Lista e Paisjeve kemi dorezuar faturat per paisjet e larte cekura, fatura nr.113 kurse ne leter sqarimin e kerkuar nga AK kemi bashkangjitur edhe specifikat qe paisjet tona kane sperkatje 5-50 mikron dhe 5-30 mikron.
Per piken 2 : "OE nuk ka sjellur deshmi per 5 pompa LV".
Deshmit per 5 pompa motorike LV i gjeni tek Lista e Paisjeve ,fatura 401102 nga Agromarket
kodi i Produktit 38107 (Sperkatese Motorike DM) ,gjithashtu te bashkangjitur jane edhe
fotografit e produktit.
Per piken 3 : OE ka sjellur vetem nje ISO certifikate,mirpo nuk ka ofruar deshmit e kerkuara nga AK Certifikaten e analizave dhe MSDS te produktit qe do te perdoret": Deshmit i gjeni tek "12.ATESTET,ANALIZAT.MSDS,CERTIFICATAT."
Ne kemi ofruar te gjithe dokumentacionin e kerkuar, duke filluar nga Atestet, certifikatat e analizave ,Msds te produktit qe do te perdoren si dhe 2 certifikatat e ISO standardeve te produkteve qe do te perdoren. (ashtu siq jane kerkuara ne dosje te tenderit)
Ne si profesionist te kesaj lamie me pervoje shume vjeqare ne kete fushe dhe me ekspert adekuat te kesaj fushe duke filluar nga Doktor shkence ne fushen e Mjedisit , Epidemiolog, Dr.Veterinar,Teknik Sanitar etj jemi bindur qe komisionet e vleresimit as qe jane ne dijeni se qka jane dokumentet e kerkuara.

Ne kemi bashkangjitur secelin prej tyre veq e veq dhe i kemi ndare ne ate menyre qe te kuptohen sa me lehte nga komisioni i vleresimit, por nga pergjigjja e dhene verehet as dokumentet tona as qe jane egzaminuar.
Janë absurde arsyet e eleminimit sepse kemi ofruar te gjitha dokumentet e kerkuara ku specifikohet qe aparatura ka sperkatje 5-50 mikron dhe ku dihet qe pompat elektrike ULV kane sperkatje 5-50 mikron.("mikronat" jane madhesia matese e grimcave qe dalin nga aparati i ULV.)
Ne me daten 30.11.2020 kemi bere Kërkesë për rishqyrtim ne AK dhe me date 03.12.2020 kemi marrur vendimin per refuzim ne ankeses per arsyet e ngjajshme :
"paisjet nuk jane sipas specifikave te kerkuara nga AK "
Pastaj per pretendimin 2 per msds ak ka dhene pergjigje si me posht :
Dokumenti i msds dhe certifikata e analizave te preparatit eshte i sakt,mirpo preparati i paraqitur nga ju nuk i ploteson kerkesat e aneksit 1,pasi qe nuk eshte ne perberjen e kerkuar".
Ne Aneksin 1 te Dosjes se tenderit jane percaktuar se me cfare preparati te dezinfektohet dhe te bashkangjiten dokumentet e tij si me posht:

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Përbërja aktive e dezinfekuesve:

- *3,35g Didecyldimethylammoniumchlorid, 3,35g Quaternary ammonium, benzyl-C12-C16-alkyldimethylchlorid, 3,3g Quaternary ammonium, C12-14-Alkyl [(ethylphenyl) methyl] dimethyl-, Chloride, Isopropanol.*
- *Ose,*
- *3.33 g Didecyldimethylammoniumchloride, 6.66 g alkyl (C12-16) dimethylbenzylammoniumchlorid.*
- *3.4 g Didecyldimethylammonium chloride, 3.4 Quaternary aminioum compound benzyl-C12-C16-alkyldimethylchlorid, 3.2 Quaternary aminioum compound benzyl-C12-C14 Alkyl[(ethylphenyl)methyl]dimethyl-, Chloride, Alcool.*
- *Hydrogen Peroxide 38.5% Peroxyacetic Acid 14% Octanoic Acid 5.3%*
- *Hydrogen Peroxide 3.30% Didecyldimethyl ammonium carbonate 2.0-4.0% Didecyldimethyl ammonium bicarbonate 1.38%*
- *Hydrogen peroxide, 22.0% Peroxyacetic acid,15.0%*
- *Peroxyacetic Acid ,15% Hydrogen Peroxide,10%*

VRËJTJE: OE duhet të cekë cilin dezinfektantues do të përdorë dhe për atë dezinfektantues duhet që të sjellë dokumentacionin percjelles si ne vijim:

o *Certifikatën e analizave*
o *MSDS*
o *Prodhuesi duhet të jetë me ISO certifikatë*

Menyra e dezinfektimit sipas nevojave dhe kërkesës nga autoriteti kontratktues 24/7 .
Afati i kryerjes se shërbimeve eshte 2 dite nga dita e pranimit te urdherit ng personi i autorizuar i AK-es.
Ne si Kompani kishim vendosur qe te perdornim keto produktet :

- *Peroxyacetic Acid ,15% Hydrogen Peroxide,10%*

Produktete keto te paraqitura ne aneksin 1 .
Ne i kishim bashkangjitur te gjitha dokumentet e nevojshme te produktit , MSDS, CERTIFIKATEN E ANALIZAVE, dhe CERTIFIKATEN E ISO STANDARDEVE TE KOMPANISE. AK ne vendimin e fundit te dates 03.12.2020 thote qe produktet qe jane paraqitur nga ne, nuk ploteson kerkesat e kerkuara ne aneksin 1 .(ME larte kam cekur kerkesat e aneksit 1, ku eshte i njejti produkt i kerkuara nga ana e AK dhe te njejtat dokumente te kerkuara nga ata,msds, certifikaten e analizave,dhe iso standardeve) AK nuk ka mundur qe te gjeje asnje arsye te vertete per te na eleminuar dhe nga panjohurit e tyre per dokumentet e produktit nxerrin si vendim qe produktet tona nuk plotesojn kerkesat e aneksit 1 . Ak ne kete procedur te prokurumit ka vepruara kundrejt nenin 1 ,6,7,59,60 te LPPK-së duke na trajtuar si te pabarabarte me tenderuesin tjeter qe eshte rekomanduar per kontrat duke na diskriminuar dhe duke mos i vleresuar drejt dokumentet tona. Njeherit AK ka rekomanduar tenderuesin me cmimin me te larte duke mos vepruar drejt dhe ne harmoni me Nenin 60, ku si kriter i dhenjes se kontrates ka qene : Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet .
Gjate shoshitjes se Dokumentacionit te Kompanise se rekomanduar per kontrat perveq qe eshte shume me i shtrenjte se Kompania jone , kjo kompani nuk ka arritur qe ti plotesoj shumicen e kerkesave qe jane kerkuar nga AK. (te gjitha te cekura me poshte)

Me datë 27.11.2020 kemi marrur Dokumentacionin e Kompanisë se rekomanduar per kontrat DDD.SH.P.K. permes usb, dhe kemi hasur ne shume leshime me apo te pa qellimta qe i ka bere komisioni i vleresimit. Perpos qe kjo kompani ka ofruar cmim shume me te shtrejte se kompania jone ata do te duhet te shpalleshin te pa pergjegjshem per keto arsyeje : 1. Kompania ne fjale DDD.SH.P.K. nuk posedon Certifikaten e Analizave te Produktit , vetem MSDS-në. 2. Kompania ne fjale ka ofruar vetem nje Pomp elektrike ULV elektrostatike 5-50 micron permes fatures nr.19-SHV01-001-1682 kurse paisjet tjera jane Nebulizator dhe Pompa ULV qe vendosen ne veture per Dezinsektim Hapsinor qe fare nuk jane kerkuara ne dosje. 3. Kompania ne fjale ka ofruar 2 certifikata te kompanise te Iso standardeve te kerkuara ne dosje , por per asnjeren nga ato nuk kemi gjetur qe egzistojn ose qe jane valide, praktikisht kjo kompani ka ofruara Dokumente fallco sepse ne web-faqen e shkruar ne certifikate per te vertetuar validitetin e tyre dhe egzistencen e tyre del qe kompania DDD.SH.P.K nuk i posedon kete certifikate. Per secilen certifikate te Iso standardeve mund qe te vertetohen ne internet egzistenca e tyre permes linqeve qe i ofron kompania e cila e ka leshuar certifikaten.
Linqet:
http://www.qeccert.com/ClientRpt1.aspx
https://qec- malaysia.com/certificate-validation/

Permeses ketyre linqeve te Kompanise kompanise qe leshon ISO standardet nuk figuron qe kjo kompania eshte e paijsur me certifiakata ISO. Ju ftojm qe te njejtin verifikim ta beni edhe ju, (permes emrit te Operatarit dhe numrit te Certifikates. Ne po ju bashkangjesim linqet ku edhe ju si Organ Shqyrtues i prokurimit mund ti vertetoni dhe te bindeni qe keto certifikate jane fallco . Gjithashtu po ju bashkangjese

edhe deshmit per kete pike.



4.Kontratat qe kjo kompani ka bere me OE –tjere ne kete rast me Truly Nolen jane te pa noterizuara, praktikisht te pavlefshme.

Kerkojm nga Organi shqyrtues i prokurimit perkatesisht paneli shqyrtues dhe nga Ekspertet Shqyrtues profesionist qe te marrin :

Vendim
Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "Vlera Sh.P.K"
Anulohet Vendimi i AK per dhenjen e Kontrates.

1. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rks-gov.net
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca 1 Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen
nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b, c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situate e tillë nuk ekziston. c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit
2.Certifikata e numrit fiscal
3. Certifikata e TVSH-se
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1.Certifikata e regjistrimit te biznesit – kopje
2.Certifikata e numrit fiskal-kopje

3. Certifikata e TVSH-se -kopje

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka kryer sherbime te ngjashme gjatë tri viteve të fundit(nga data e publikimit te ketij Njoftimi) në vlerë minimale 70.000 euro.

2. OE duhet te dorëzoj licencen e leshuar nga MBPZHR per perdorimin e preparateve dhe kryerjen e sherbimeve per DDD brenda territorit te Republikes se Kosoves

3.OE duhet te jete i certifikuar me standardet ISO 9001 2015 per cilesine e sherbimeve te DDD nga nje kompani e licensuar-te preznetohet licenca e kompanise

4.OE duhet te jete i certifikuar me standardet ISO 14001 2015 per cilesine e sherbimeve te DDD nga nje kompani e licensuar-te preznetohet licenca e kompanise

5. Një epidemiolog te diplomuar me se paku një vit përvoje pune

6. **Nuk aplikohet**

7. **Nuk aplikohet.**

8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit –ULV Elektrostatike – min. 3 copa me sperkatje 5-50 mikron , - Pompa dore profesionale Nebulizator elektrik dore me sperkatje 5-30 mikron – min. 2 copa, - Pompa motorike LV – 5 copa - Automjete te pershtatshme per kete aktivitet - 3 copa

9.OE-ik duhet te perdor dezinfektuesit adekuat per eleminimin e Covid -19 , me perberje te paraqitur ne Aneksin 1

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Operatori ekonomik duhet te plotësoj një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te sherbimeve.

2.Kopjen e licences valide te leshuar nga MBPZHR per perdorimin e preparateve dhe kryerjen e sherbimeve per DDD

3.Kopjen e certifikates valide ISO 9001 2015 ne emer te OE-ik

4.Kopjen e certifikates valide ISO 14001 2015 ne emer te OE-ik

5.Për epidemiologun kopjen e diplomës universitare(Ku deshmon se personi ne fjale ka te kryer fakultetin e mjeksise) ,certifikaten e specializimit ne lemine e epidimiologjise(ku deshmon se ka te kryer specializimin ne lemine e Epidemilogjise) CV dhe kontratën për marrëdhënie pune ose marrëveshjen mbi angazhimin për këtë projekt.

6. **Nuk aplikohet**

7. **Nuk aplikohet.**

8.Te deshmohet pronesia me fature te blerjes, libreze te qarkullimit te automjeteve,DUD doganor ose kontrate te marrjes me qira per kete aktivitet.

9. Atestet, certifikata e analizes per dezinfektim me fokus kunder Covid -19 ,fatura e blerjes ose marreveshja per furnizim

Aneksi 1

Specifikimi teknik me date 02.09.2020 Përbërja aktive e dezinfekuesve:

• 3,35g Didecyldimethylammoniumchl orid, 3,35g Quaternary ammonium, benzyl-C12-C16-alkyldimethylchlorid, 3,3g Quaternary ammonium, C12- 14-Alkyl [(ethylphenyl) methyl] dimethyl-, Chlòride,

Isopropanol.

• Ose, • 3.33 g Didecyldimethylammoniumchl oride, 6.66 g alkyl (C12-16) dimethylbenzylammoniumchl orid.

• 3.4 g Didecyldimethylammonium chloride, 3.4 Quaternary aminioum compound benzyl- C12-C16-alkyldimethylchlorid, 3.2 Quaternary aminioum compound benzyl-C12-C14 Alkyl[(ethylphenyl)methyl]di methyl-, Chloride, Alcool.

• Hydrogen Peroxide 38.5% Peroxyacetic Acid 14% Octanoic Acid 5.3%

• Hydrogen Peroxide 3.30% Didecyldimethyl ammonium carbonate 2.0- 4.0% Didecyldimethyl ammonium bicarbonate 1.38%

• Hydrogen peroxide, 22.0% Peroxyacetic acid,15.0%

• Peroxyacetic Acid ,15% Hydrogen Peroxide,10%

VRËJTJE: OE duhet të cekë cilin dezinfektantues do të përdorë dhe për atë dezinfektantues duhet që të sjellë dokumentacionin

percjelles si ne vijim:

o Certifikatën e analizave

o MSDS

o Prodhuesi duhet të jetë me ISO certificate Menyra e dezinfektimit sipas nevojave dhe kërkesës nga autoriteti kontratktues 24/7 . Afati i kryerjes se shërbimeve eshte 2 dite nga dita e pranimit te urdherit ng personi i autorizuar i AK-es.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlersimit konstaton se per kete tender jane dorzuar 5 oferta dhe jep sqarimet si ne vijim: OE –ik Dezinfektimi profesional- ky tenderues duhet eshte i pa suksesshem i eleminuar duke u bazuar ne ankesat e cekura me posht

Kerkesa 1. Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se ka kryer sherbime te ngjashme gjat 3 viteve te fundit (nga data e publikimit te ketije njoftimi) ne vlere minimale 70000 Euro.

Deshmia: 1. Operatori ekonomik duhet te plotesoj nje liste te kontratave te realizuara, duke plotesuar aneksin6 te dosjes se tenderit ku duet saktesuar titullin e kontrates, shumen e kontrates, daten e fillimit dhe daten e perfundimit dhe perfituesin si dhe listes ti bashkengjiten referencat ose certifikatat per kryerjen e sherbimeve.

Ndersa OE –ik ka dorezuar listen e kontratave te realizuara gjate tri viteve te fundit, mirepo nga kjo liste komisioni i vleresimit ka pranuar vetem 2 kontrata te cilat jane realizuara para publikimit te njoftimit per kontrate ne perputhje me kereksen e parashtruar ne dosjen e tenderit AK ka marr parasysh vetem dy kontrata te cilat e arrin vleren 9.000,00 E ndersa kerkesa e AK ka qen 70.000,00.

Kerkesa 6 Operatori ekonomik duhet te posedoj mjete, stabailimetet dhe pajisje teknike qe jane te

domosdoshme per realizimin e projektit

- ULV elektrostatike –min. 3 copa me sperkatje 5-50 mikron,
- Pompa dore profesionale Nebulizator elektrik dore me sperkatje 5-30 mikron – min. 2 copa,
- Pompa motorike LV – 5 copa
- Automjete te pershtatshme per kete aktivitet – 3 copa

Deshmia: te deshmohet pronesia me fature te blerjes, libreze te qarkullimit te automjeteve, DUD doganor ose kontrate te marrjes me qera per kete aktivitet.

Ndersa OE –ik nuk ka dorezuar listen apo deshmit qe deshmon se i posedon: ULV elektrostatike-min 3 copa me sperkatje 5-50 mikron, pompa dore profesionale Mebulizator elektrik dore me sperkatje 5-30 mikron – min. 2 copa dhe pompa motorike LV – 5 copa. Per pajisjet ju keni dorezuar 3 automjete megjithate pajisjet jane ne emer te kompanise Zuka . Me qene se nuk keni konkuruar si konzercium, nuk keni dorzuar as kontrate te marrjes me qera te cilat deshmi do te mund te ju kerkohej ne perputhje me nenin 72 te LPP-se sikur ti plotesonit kerkesat tjera.

Kerkesa 7 OE-ik duhet te perdor dezinfektuesit adekuat per eleminimin e covid-19, me perberje te paraqitur ne Aneksin1 Deshmia: Atestet, certifikata e analizes per dezinfektim me fokus kunder covid-19, fatura e blerjes ose marrveshja per furnizim.

OE-ik nuk ka dorzuar specifikim teknik per preparation ne perputhjke me aneksin 1 te dosjes te tenderit, nuk ka dorzuar atestet, certifikaten e analizes.

OE-ik vlera ky tenderues eshte i pa suksesshme i eleminuar duke u bazuar ne ankesat e cekura me poshte

1kerksa6 Operatori ekonomik duhet te posedoj mjete stabilimetet dhe paisjet teknike qe jane te

Paisjet jane kerkuar

ULV elektrostatike – min. 3 copa me sperkatje 5-50 mikron,

Pompa dore profesionale mebulizator elektrik dore me sperkatje 5-30 mikron – min. 2 copa,

Ndersa OE ne deshmite e pajisjeve te cekura me lart nuk jane te cekura mikronat

OE nuk ka deshmuar deshmi te mjaftueshme per pompat LV 5copa.

2. Kerkesa 6 ka qen qe OE-ik duhet te perdor dezinfektuesit adekuat per eleminimin e covid -19 me perberje te paraqitur ne aneksin 1. Deshmi: asetet, certifikata e analizes per dezinfektimin me fokus covid-19, fatua e blerjes ose marrveshja per furnizim ne perputhje me nenin 72 te LPP-se kerkojme qe te dorzohen: asetet, certifikata e analizes dhe MSDS

OE ka ofruar vetem nje ISO certifikate mirpo nuk ka ofruar deshmi te kerkuar nga AK certifikaten e analizes dhe MSDS.

OE-ik Lulzim Ktanolli – ky tenderues duhet eshte i paskusksesshem i eleminuar duke u bazuar ne ankesat e cekura me poshte

1.Kerkesa 6 OE duhet te posedoj mjete stabilimetet dhe pajisjet teknike qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit

-ULV elektrostatike – min3 copa me sperkatje 5-50 mikro,

-Pompa dore profesionale Mebulizator elektrik dore me sperkatje 5-30 mikron – min. 2 copa,

-Pompa motorike LV – 5copa

-Automjete te pershtatshme per kete aktivitet – 3copa

Deshmia: te deshmohet pronsia me fature te blerjes, libreze te qarkullimit te automjeteve, DUD doganor ose

kontrate te marrjes me qera per kete aktivitet.
OE nuk ka dorezuar dokumente per pajisjet pronsia dhe afaturat e blerjes per pajiseve: ULV elektrostatike dhe pompa dore profesionale Mebulizator elektrik dore me sperkatje pa mikrona.
2.Aneksi1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME
Kerkesa e AK: OE duhet te ceke cilen dezinfektantues do te perdor dhe per ate dezifektatues duhetqe te sjell dokumentacionin percjelles si ne vijim

- Certifikaten e analizave
- MSDS
- Prodhuesi duhet te jete me ISO certifikate

Menyra e dezinfektimit sipas nevojave dhe kerkeses nga autoriteti kontraktues 24/7.
Afati i kryerejes se sherbimeve eshte 2 dite nga dita e pranimit te urdherit nga personi i autorizuar i AK-se
OE nuk posedon certifikaten e analizes dhe MSDS
OE-ik Samirja – ky tenderues duhet eshte i pasuksesshem i eleminuar duke u bazuar ne ankesat e cekura me poshte
1.Kerkesa ka qene 6 operatori ekonomik duhet te posedoj mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe jane te domosdoshme per realizimin e projketit
-OLV elektrostatike –min. 3copa me sperkatje 5-50 mikron
-Pompa dore profesionale, mebulizator elektrik dore me sperkatje 5-30 mikron –min. 2copa,
-Pompa motorike LV -5copa
- Automjete te pershatshme per kete aktivitet – 3 copa
Deshmia: te deshmohet pronsia me fature te blerjes, librez te qarkullimit te automjeteve, DUD doganor ose kontrate te marrjes me qera per kete aktivitet.
Ndersa OE nuk i ka deshmite te cilat deshmojne pajisjet e kerkuara si psh. – ULV elektrostatike – min 3copa me sperkatje 5-50 mikron, - si ne kerkesen e DT
2.Aneksi1. SPECIFIKIME TEKNIKE TE DETYRUESHME
Kerkesa e AK : OE duhet te ceke cilin dezinfektantues do te perdore dhe per ate dezinfektantues duhet qe te sjell dokumentacionin percjelles si ne vijim:

- Certfikaten e analizave
- MSDS
- Prodhuesi duhet te jete me ISO certifikate

Menyra e dezinfektimit siaps nevojave dhe kerkeses nga AK 24/7.
Afati i kryerjes se sherbimeve eshte 2 dite nga dita e pranimit te urdherit nga personi i autorizuar i AK-se
OE nuk posedon certifikaten adekuate te analizes dhe MSDS
Ne baze te krejte kesaje komisioni rekomandon per kontrate OE DDD SH.P.K me qmimin prej 68 400,00E

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: "KK –PRISHTINË" gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës kontratë publike kornizë – Sherbim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK, sipas afateve të parapara me LPP. AK përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE "VLERA SH.P.K"

Sa i perket pretendimit ankimor te operatorit ekonomik "VLERA SH.P.K" per piken 1, si : OE nuk ka sjellur deshmit qe paisjet tona kane sperkatje 5-50 mikron dhe 5-30 mikron

Eksperti shqyrtues/teknik sqarton se ne **Dosjen e tenderit - III.2.4) Kapaciteti teknik dhe professional**, pika 8. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit –ULV Elektrostatike – min. 3 copa me sperkatje 5-50 mikron , - Pompa dore profesionale Nebulizator elektrik dore me sperkatje 5-30 mikron – min. 2 copa, - Pompa motorike LV – 5 copa - Automjete te pershtatshme per kete aktivitet - 3 copa, tek **Deshmi e kerkuar** nuk eshte cekur se si duhet te deshmohet nje gje e tille, vetem se kerkohet te deshmohet pronesia me fature te blerjes, libreze te qarkullimit te automjeteve, DUD doganor ose kontrate te marrjes me qira per kete aktivitet. Perveq kesaj OE ankues e ka deshmuar kete perms leter sqarimit te kerkuar nga AK, nje gje te till e pranon edhe AK perms vendimit per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim te OE vlera te dt. 03.12.2020 , ku thuhet:

- **Pretendimet tuaja se ju keni dorezuar sqarime per pajisje eshte i sakte,** mirepo komisioni professional ka konstatuar se ato nuk jane pajisje sipas specifikave te kerkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Ne si ekspert konstatojm se ne baz te specifikave te paraqitura, keto pajisje jane te mjaftueshme per kryerjen e ketyre aktiviteteve

Sa I perket pretendimit ankimor te OE "VLERA SH.P.K" per piken 2, si : "*OE nuk ka sjellur deshmi per 5 pompa LV*".

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se OE ankues ka ofruar deshmi per 5 pompa motorike LV te cilat i shikuam tek Lista e Paisjeve, fatura 401102 nga Agromarket kodi i Produktit 38107 (Sperkatese Motorike DM), gjithashtu te bashkangjitur, nje gje te till e pranon edhe AK perms vendimit per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim te OE vlera te dt. 03.12.2020 , ku thuhet:

- **Pretendimet tuaja se ju keni dorezuar sqarime per pajisje eshte i sakte,** mirepo komisioni professional ka konstatuar se ato nuk jane pajisje sipas specifikave te kerkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Ne si ekspert shqyrtues/teknik sqarojm se per aq sa jan kerkuar specifika teknike, keto pajisje I pergjigjen ketyre specifikave per kryrjen e aktiviteteve te paprapara ne kete aktivitet te prokurimit, perndryshe eshte dasht qe te kerkohen specifika me te detajuara.

Sa i perket pretendimit ankimor te OE "VLERA SH.P.K" per piken 3, si : *OE ka sjellur vetem nje ISO certifikate,mirpo nuk ka ofruar deshmit e kerkuara nga AK Certifikaten e analizave dhe MSDS te produktit qe do te perdoret"*

Ne si ekspert shqyrtues/teknik kemi shiquar me shume kujdes oferten e OE ankues Vlera dhe kemi vertetuar se OE ka ofruar *certifikatat ISO, Certifikaten e analizave dhe MSDS te produktit qe do te perdoret", te bashkengjitur tek* "12.ATESTET,ANALIZAT.MSDS,CERTIFICATAT." nje gje te till e pranon edhe AK perms vendimit per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim te OE vlera te dt. 03.12.2020 , ku thuhet:

- **Poashtu pretendimi juaj se me sqarimet e dorezuara keni paraqitur edhe dokumentet MSDS dhe Certifikaten e analizave te preparatit eshte I sakte,** mirepo preparati i paraqitur nga ju nuk ploteson kerkesat e Aneksit 1 te Autoritetit Kontraktues, pasiqe nuk eshte me perberjen e kerkuar

Sa I perket pretendimit te AK-se per OE ankues Vlera, ku thuhet se preparati I paraqitur nga ju nuk ploteson kerkesen e Aneksit 1 te AK-se, pasi qe nuk eshte me perberjen e kerkuar.

Ne si ekspert shqyrtues/teknik e shiquam me shume kujdes oferten e OE ankues dhe e krahasuam me kerkesat e kerkuara ne Aneksin 1, ku viejm ne perfundim se OE ankues ka ofruar produktin me perberje Peroxyacetic Acid, 15% Hydrogen Peroxide, 10%, ashtu sic kerkohet ne Aneksin1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME, ku thuhet:

- **Ne Si Operator VLERA SH.P.K. Do I Perdorim Keto *dezinfektues* Te Paraqitur Ne Aniksin 1 Peroxyacetic Acid ,15% Hydrogen Peroxide,10%**

Eksperti shqyrtues, lidhur me prtendimin e OE ankues se kompania ne fjale DDD.SH.P.K. nuk posedon Certifikaten e Analizave te Produktit , vetem MSDS-në. Ne oferten e dorezuar ne sistemin e e-prokurimit, OE i rekomanduar per kontrate, nuk e ka dorezuar certifikaten e analizave.

Lidhur me pretneidmin se kompania ne fjale ka ofruar vetem nje Pomp elektrike ULV elektrostatike 5-50 micron permes fatures nr.19-SHV01-001-1682 kurse paisjet tjera jane Nebulizator dhe Pompa ULV qe vendosen ne veture per Dezinsektim Hapsinor qe fare nuk jane kerkuara ne dosje. Eksperti shqyrtues/teknik pas analizimit te specifikave teknike te pajisjes se ofruar vlereson se i njejti i ka plotesuar specifikat teknike.

Sa i perket pretenditimt te OE ankues se kompania ne fjale ka ofruar 2 certifikata te kompanise te Iso standardeve te kerkuara ne dosje , por per asnjeren nga ato nuk kemi gjetur qe egzistojn ose qe jane valide, praktikisht kjo kompani ka ofruara Dokumente fallco sepse ne webfaqen e shkruar ne certifikate per te vertetuar validitetin e tyre dhe egzistencen e tyre del qe kompania DDD.SH.P.K nuk i posedon kete certifikate.

Eksperti shqyrtues/teknik, vlereson se per cdo dyshim AK-ja, gjate rivlersimit te ofertave, konform nenit 72 te LPP-se, te verifikoje validitetin dhe origjialitetin e certifikateve ISO.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndersa vendimi per shenie te kontrates te anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - (AK)- "KK -PRISHTINË
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - OE "VLERA" SH.P.K Prishtinë